



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 5887 Prot.

Lezhë, më 31 . 03 . 2021

VENDIM

Nr. 57 Datë 30 . 03 . 2021

Për një shtesë dhe ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2021

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetë qeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të VKM nr.110, datë 24.02.2021, VKM nr. 149, datë 10.03.2021; të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, date 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”; dhe të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.3572/2, date 08.03.2021 “Mbi zbatimin e VKM-së nr.68, datë 03.02.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1. Miratimin e një shtesë në buxhetin e bashkisë për vitin 2021 si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2021 në shumën 23 400 000 lekë dhe për vitin 2022 në shumën 93 600 000 lekë

1/2-Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor “Shërbimet Kulturore ” në shumën 23 400 000 lekë për vitin 2021 dhe në shumën 93 600 000 lekë për vitin 2022.

Veprimet të kryhen si më poshtë :

- Pakësohet : Gr.00, Prog.04960, Kap.01, Art.604 në shumën 117 000 000 lekë.
- Shtohet : Gr.00, Prog.08220, Kap.01, Art.231 në shumën 117 000 000 lekë lekë i ndarë si më poshtë :
 - ✓ Punime të ndërtimit të objektit : 114 037 605 lekë
 - ✓ Mbikqyrja e punimeve : 2 794 712 lekë
 - ✓ Kolaudimi dhe përgatitja e dokumentacionit përfundimtar : 167 683 lekë

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

